



Koalicion vetëm me ata që janë për shkëmbim të territoreve

Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka thënë se kushti i kësaj partie për të bërë koalicion parazgjedhor me subjektet e tjera politike është për shkëmbimin e territoreve Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Klinaku ka bërë me dije se LB-ja këtë herë do të bëjë koalicion vetëm me ato parti që e përkrahin këtë ide.

Ai ka thënë se shkëmbimi i territoreve është e vetmja rrugë për ta zgjidhur problemin shekullor në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, kjo çështje nuk do të mbyllet derisa nuk zgjidhet përfundimisht. "Zgjidhja e çështjes shqiptaro-serbe bëhet vetëm nëpërmjet ndërrimit të territoreve në bazë të vijave etnike", ka thënë Klinaku

DREJTUESIT E PARTIVE POLITIKE SHTOJNË TAKIMET ME QYTETARË NË TERREN | FAQE 3

Partitë politike para kohe fillojnë fushatën zgjedhore



Edhe pse ende nuk është shpërndarë Kuvendi dhe nuk janë shpallur zgjedhjet e parakohshme, partitë politike kanë filluar fushatën zgjedhore. Liderët e subjekteve politike këtyre ditëve kanë shtuar takimet me strukturat partiake dhe me qytetarët në terren. Së fundi janë shtuar edhe aderimet nëpër subjektet politike. Megjithatë, njohësit e proceseve politike dhe zgjedhore kanë vlerësuar se kjo fushatë nuk do t'u ndihmojë partive politike për rritjen e elektoratit

Ministri Ismaili i siguron mjekët dhe infermierët: Pagat do t'i merrni me rritje

FAQE 7



AKTUALE



LISTA TË PASTRA ZGJEDHORE, ENDE VETËM DËSHIRË F. 6

META: ZGJEDHJE MË 13 TETOR NË GJITHË SHQIPËRINË F. 2

SHBA-ja LARGOHET NGA BORDI I AGJENCISË PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS NË KOSOVË F. 3

O'CONNELLI: FSK-ja ËSHTË NJË PREJ SUKSESEVE TË KOSOVËS PAS LUFTËS F. 7



EKONOMI

MINISTRI SHALA VENDOS MASA RECIPROKE PËR PRODUKTET E MAQEDONISË SË VERIUT F. 9

QYTETARËT E KOSOVËS TYMOSIN MBI 300 MILIONË EURO DUHAN F. 9

SPORT

RIKTHEHET FUTBOLLI F. 16



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Zgjedhje më 13 tetor në gjithë Shqipërinë



TIRANË, 16 GUSHT - Presidenti Ilir Meta pohon se nuk do ta dekretojë përsëritjen e zgjedhjeve për Bashkinë e Shkodrës, pas dorëheqjes së kryetarit të zgjedhur Valdrin Pjetri. Presidenti Meta pohoi se sipas ligjit për pushtetin vendor, Bashkia e Shkodrës do të vazhdojë të drejtohet nga kryetarja aktuale Voltana Ademi. "Nuk ka

nevojë, zgjedhjet janë më 13 tetor për gjithë Shqipërinë, përfshirë edhe Shkodrën. Këto janë të vetmet zgjedhje të ligjshme përpara. Deri në marrjen e detyrës nga kryetari i ri, detyrën e mban kryetari që është në detyrë", tha Meta. Sipas kreut të shtetit, rasti i Valdrin Pjetrit tregoi se duhet një hetim i

thelluar mbi funksionimin e institucioneve shqiptare. "Problemi nuk është i personit në fjalë, sepse ai, edhe pse ka bërë një shkelje të ligjit, ka pasur një bashkëpunim të shkëlqyer me policinë italiane në rastin konkret. Problemi është kapja e institucioneve që nuk kanë bërë punën e tyre për ta verifikuar shkeljen e ligjit në rastin në

fjalë", u shpreh presidenti. "Fakti që personi ka pasur edhe detyra të mëparshme dhe certifikata të sigurisë të nivelit të lartë, për shkak të detyrave, tregon se duhet të bëhet një hetim më i thelluar për funksionimin e institucioneve të pavarura të shtetit që verifikojnë integritetin e të gjithë zyrtarëve tanë", tha Meta.

Leyen: Shqipëria, një aleate e denjë

Gjatë ceremonisë së organizuar në Berlin, për nder të saj, ish-ministrja e Mbrojtjes e Gjermanisë, tanimë presidente e Komisionit Evropian, i shprehu ministres së Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka, vlerësimet për rolin e saj në marrëdhëniet me NATO-n, duke e cilësuar Shqipërinë një aleate të denjë



TIRANË, 16 GUSHT - Presidentja e sapozgjedhur e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, vlerëson rolin e Shqipërisë në aleancën më të madhe ushtarake në botë, NATO. Gjatë ceremonisë së organizuar në Berlin, për nder të saj, ish-ministrja e Mbrojtjes e Gjermanisë, tanimë presidente e KE-së, i shprehu nominalisht ministres së Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka, vlerësimet për rolin e saj në marrëdhëniet në mes të Shqipërisë dhe NATO-s, duke e cilësuar Shqipërinë një aleate të denjë. "Gjithmonë kam admiruar rrugëtimin tënd pasi

u bërë pjesë e tryezës së NATO-s. Jam e lumtur që sot Shqipëria është një anëtare e denjë e Aleancës", iu drejtua von der Leyen, ministres Xhaçka. Në krah të kancelares gjermane Angela Merkel, zëvendëssekretares së përgjithshme të NATO-s, Rose Gottemoeller, ministres së re të Mbrojtjes së Gjermanisë, Annegret Kramp-Karrenbauer dhe dhjetëra personaliteteve gjermane dhe evropiane, ministrja Xhaçka mori pjesë në një prej ceremonive më të veçanta ushtarake, me traditë 200-vjeçare, që u rezervohet personaliteteve më të spikatura të

politikës, ku ishin të ftuar bashkëpunëtorët më të afërt të ish-ministres Ursula von der Leyen. Kancelarja Merkel përshëndeti përzemërsisht ministrin

Xhaçka, me të cilën, bashkë me 200 të ftuar të tjerë, ndoqën ceremoninë zyrtare të largimit nga detyra të Von der Leyen dhe vijimin, në postin e ministrit të Mbrojtjes së Gjermanisë të

Annegret Kramp-Karrenbauer. Ursula von der Leyen është e para grua që zgjedhet presidente e Komisionit Evropian dhe pritet ta marrë zyrarisht detyrën më 1 nëntor 2019.

Ndahet nga jeta gazetari dhe publicisti Fatos Baxhaku



TIRANË, 16 GUSHT - Ka ndërruar jetë gazetari dhe publicisti Fatos Baxhaku, një prej emrave të shquar të gazetarisë postkomuniste në Shqipëri. Lajmi për ndarjen nga jeta të Baxhakit 55 vjeç është publikuar nga miqtë në rrjetet sociale. Zemra e tij ka pushuar së rrahuri pasditen e të premtes duke e humbur betejën me një sëmundje të rëndë nga e cila vuante prej disa kohësh. Një penë brilante në reportazh

bërjen e më pas në realizimin e shumë dokumentarëve Fatos Baxhaku la gjurmë si një kritik i fortë i tranzicionit shqiptar. Baxhaku ka lindur në Tiranë më 9 janar në 1964. Shkollimin e parë e ka kryer në shkollat asokohe 8-vjeçare, "Emin Duraku" dhe "20-Vjetori" (sot Dora D'Istria). Shkollimin e mesëm e ka kryer në Gjimnazin "Ismail Qemali". Përgjatë viteve 1982-1986 kishte studiuar në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Histori-Filogjisë,

kurse ishte diplomuar në histori. Nga viti 1993 e deri më 1998 ishte bashkëthemelues, kryeredaktor dhe gazetar i "Gazetës Shqiptare". Në periudhën e viteve 1998-1999 ishte kryeredaktor i parë i lajmeve në televizionin "Klan", më 1999-2000 kryeredaktor i revistës së përjavshme "XXL", nga viti 2001 deri më 2005 kryeredaktor dhe gazetar në televizionin "Vizion Plus", në vitet 2006-2015 ishte kryeredaktor dhe gazetar në të përditshmen "Shqip".

Erdogani në fund të këtij muaji viziton Serbinë

ANKARA, 16 GUSHT - Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, do të zhvillojë një vizitë zyrtare në Serbi më 29 gusht. Gjatë vizitës Erdogan do të takohet me homologun serb Aleksandar

Vučiq dhe me zyrtarë të tjerë të lartë. Qëllimi kryesor i vizitës së presidentit turk në Serbi lidhet me nisjen e punimeve për ndërtimin e autostradës Beograd

- Sarajevë. Pjesë e projektit që kap shifrën e 3 miliardë eurove është edhe kompania turke Tasyapi. Vetë Turqia financon një pjesë të konsiderueshme të autostradës.

Presidenti i Turqisë ka qenë për herë të fundit në shtetin serb në tetor të 2017-s, ndërkohë që marrëdhëniet ekonomike midis Ankarasë dhe Beogradit kanë shënuar nritje të konsiderueshme.



Drejtuesit e partive politike shtojnë takimet me qytetarë në terren

Partitë politike para kohe fillojnë fushatën zgjedhore

Edhe pse ende nuk është shpërndarë Kuvendi dhe nuk janë shpallur zgjedhjet e parakohshme, partitë politike kanë filluar fushatën zgjedhore. Liderët e subjekteve politike këtyre ditëve kanë shtuar takimet me strukturat partiake dhe me qytetarët në terren, ku nuk po mungojnë as premtimet. Së fundi janë shtuar edhe aderimet nëpër subjektet politike. Por njohësit e proceseve politike dhe zgjedhore kanë vlerësuar se kjo fushatë nuk do t'u ndihmojë partive politike për rritjen e elektoratit

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ndonëse ka mbetur edhe një javë deri te mbajtja e seancës për shpërndarjen e Kuvendit dhe më pas caktimi i datës së zgjedhjeve të parakohshme, partitë politike kanë filluar aktivitetet elektorale. Këtyre ditëve janë shtuar takimet e liderëve partiakë me struktura dhe me qytetarë. Vetëm gjatë kësaj jave liderët e subjekteve më të mëdha në vend kanë realizuar dhjetëra takime me grupe të ndryshme të qytetarëve, rini, ish-luftëtarë, biznesmenë dhe sipërmarrës.

Për këtë fushatë të parakohshme për gazetën "Epoka e re" ka folur analisti politik Behxhet Shala. Ai ka vlerësuar se në këta gjashtë muaj është shtuar fushata nga të gjithë liderët e pozitës dhe të opozitës. "E kemi parë që shumicën e rasteve liderët politikë i kanë kaluar nëpër terren, në takime me degë, nëndegë, biznese ku kanë shpalosur programet dhe premtimet e tyre për qeverisjen e ardhshme. Është një fushatë e pashpallur. Fushata elektorale për zgjedhje të parakohshme po zgjat më shumë sesa të ishin zgjedhje të rregullta. Domethënë, po bëhen përgatitje për të shpëtuar atë që mund të shpëtohet, sepse asnjë parti politike nuk është e gatshme për zgjedhje,

lëreni ju se çfarë deklarojnë ata", ka theksuar Shala.

Ai ka thënë se fushata e parakohshme më shumë po bëhet për t'iu vardisur ndonjërit subjekt sesa për të krijuar elektorat të ri. "Përmes kësaj fushate nuk po luftohet për elektorat, por për pozicion politik. Me këtë fushatë këta po duan ose ta frikësojnë partnerin në zgjedhje ose t'i vardisen ndonjërit subjekt politik në mënyrë që ta bëjnë ose një koalicion parazgjedhor për ta siguruar mbijetesën politike apo të bëjnë një marrëveshje për një koalicion pas zgjedhjeve", është shprehur Shala, duke shtuar se kjo fushatë e parakohshme nuk do t'i ndihmojë subjektet politike për rritjen e elektoratit. "Kjo është një fushatë legale, por e pamëshetur në rregullat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Por, meqenëse nuk ka diçka që e sanksionon, atëherë fushata po vazhdon. Sidoqoftë, nuk besoj se kjo fushatë do t'u ndihmojë subjekteve politike për rritjen e elektoratit. Madje dikujt kjo fushatë do t'i kthehet bumerang", ka theksuar Shala. Edhe të premtën lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka vazhduar aktivitetin elektorale, duke u takuar me bashkëluftëtarë. Në takim me ta ai ka premtuar se do të angazhohet për t'i luftuar korrupsionin dhe nepotizmin si dhe për ndërtimin e një të

ardhme më të mirë në Kosovë. "E fillova mëngjesin sot me bashkëluftëtarët e mia nga koha e luftës. Ishte kthim në kohë biseda me gratë në uniformë të UÇK-së, të cilat kanë dhënë kontribut vendimtar, por nuk e kanë marrë kurrë lavdinë që e meritojnë. Theksuam njëzëri se ky nuk është vendi për të cilin kemi luftuar, që fëmijët tanë të largohen për shkak të mungesës së perspektivës. Do të angazhohem - me tërë fuqinë time - ta luftoj korrupsionin dhe nepotizmin, që të ndërtojme një të ardhme më të mirë në Kosovën tonë. Për një ekonomi të lirë dhe të bazuar në mundësi të barabarta për të gjithë. Së bashku, sikurse ishim në luftë, do të jemi edhe sot kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Fituam atëherë, do të fitojmë edhe sot", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkohë pasditen e së premtës Veseli është takuar me strukturat e partisë në Gjakovë. Edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, të premtën është takuar me drejtuesit e degëve të

Nismës në Gjilan, Kamenicë, Viti dhe Kllkot. Në këtë takim është bërë me dije se degët e Nismës në Anamoravë janë të gatshme për procesin zgjedhor që po e pret vendin.

Me këtë rast, Limaj ka thënë se Nisma do të jetë përcaktuese për qeverinë e ardhshme duke shtuar se vendit i duhet një qeveri e fortë, e cila do t'i adresojë temat e mëdha në interes të vendit si dhe do të angazhohet fuqishëm për zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. "Tanimë të gjitha degët tona janë mobilizuar në funksion të arritjes së objektivave të Nismës Socialdemokrate. Shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme, me bindje të plotë se në legjislaturën e VII Nisma Socialdemokrate do të jetë e përfaqësuar me 10 + deputetë", është thënë në komunikatën për medie të Nismës.

Takime me qytetarë këtyre ditëve ka mbajtur edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe ai i LV-së, Albin Kurti. Krahas takimeve janë shtuar edhe aderimet nëpër subjekte politike.

Lëvizjes Vetëvendosje (LV) të

premtën iu ka bashkuar kryesuesi i Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, profesori Shpejtim Bulliqi. Me këtë rast kryetari Albin Kurti ka thënë se me Bulliqin në Vetëvendosje dhe me Lëvizjen në qeverisjen e ardhshme, kufijtë e shtetit tonë do të jenë të paprekshëm. "Shpejtim Bulliqi, së bashku me profesorët Zejnullah Gruda dhe Florim Isufi, ishin në krye të argumentimit shkencor për kundërshtimin e demarkacionit Thaçi - Meha që Republikës sonë ia cenoit territorin. Me profesor Bulliqin në Vetëvendosje dhe me Lëvizjen në qeverisjen e ardhshme, kufijtë e shtetit tonë do të jenë të paprekshëm", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Një ditë më parë në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka aderuar trajneri i xhudos Driton Kuka. AAK-së më herët i është bashkuar edhe ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Bajram Hasani, si dhe ish-ministrja e AKR-së, Albena Reshitaj.



ShBA-ja largohet nga bordi i Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës në Kosovë

PRISHTINË, 16 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë larguar nga bordi i Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës në Kosovë, duke konsideruar se në krye të këtij institucioni është një person i pakualifikuar.

Për emërimin e Naser Shalës në këtë pozitë pati reaguar edhe Britania e Madhe, dhe ambasadori i saj në Prishtinë,

Ruairi O'Connell ishte larguar po ashtu nga bordi. "Ne nuk do të jemi aty kur udhëheqësi u shërben interesave personale dhe atyre politike në vend të njerëzve. Përzgjedhja e personave joadekuatë për pozita qeveritare dëmton imazhin e Kosovës dhe besimin publik", është thënë në një postim të ambasadës amerikane në rrjetin social "Facebook".

Ka qenë i menjëhershëm reagimi i kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli pas lajmit se edhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane janë larguar nga Bordi i Agjencisë Kosovare të Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës.

Veseli nëpërmjet një statusi në llogarinë e vet "Facebook" se nepotizmijovetëm që po e dëmton Kosovën por edhe marrëdhëniet me aleatët përëndimor.



Flet për "Epokën e re", Avni Klinaku

Koalicion vetëm me ata që janë



Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka thënë se kushti i kësaj partie për të bërë koalicion parazgjedhor me subjektet e tjera politike është për shkëmbimin e territoreve Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Klinaku ka bërë me dije se LB-ja kësaj here do të bëjë koalicion vetëm me ato parti që e përkrahin këtë ide. Ai ka thënë se shkëmbimi i territoreve është e vetmja rrugë për ta zgjidhur problemin shekullor mes Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, kjo çështje nuk do të mbyllet derisa nuk zgjidhet përfundimisht. "Zgjidhja e çështjes shqiptaro-serbe bëhet vetëm përmes ndërrimit të territoreve në bazë të vijave etnike", ka thënë Klinaku

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 16 GUSHT - Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka deklaruar se kjo parti do të bëjë koalicion parazgjedhor vetëm me ato subjekte politike që përkrahin shkëmbimin e territoreve Kosovë - Serbi. Ai ka treguar se këtë kusht ia kanë bërë të qartë edhe PDK-së, me të cilën kanë bashkëpunuar në

dy palë zgjedhjet e fundit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Klinaku ka deklaruar se vetëm përmes shkëmbimit të territoreve mund të zgjidhet problemi shekullor shqiptaro-serb. "Është e vërtetë që herëve të kaluara kemi bërë koalicione parazgjedhore por, siç e di i gjithë opinioni, ato kanë qenë koalicione jo mbi bazën programore, çka nuk do të ndodhë kësaj radhe. Lëvizja për

Mustafa: Bulliqi dhe Haradinaj e kanë për borxh t'ia kthejnë Çakorrin Kosovës



PRISHTINË, 16 GUSHT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ismet Mustafa, ka komentuar aderimin e ish-deputetit Shpejtim Bulliqi nga partia e tij në Lëvizjen Vetëvendosje. Mustafa në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se vendimi i tij për të kaluar në cilëndo parti është personal, por ka

konsideruar se Bulliqi i ka mbetur borxh Kosovës. Sipas Mustafës, ai së bashku me kryeministrin në dorëheqje, Ramush Haradinaj, duhet ta marrin përgjegjësinë për kthimin e kufirit në Zhleb dhe Çakorr. "Është çështje e vullnetit të tij politik, mirëpo Shpëtimi i ka mbetur borxh këtij vendi

çështjen e kufirit me Malin e Zi. Ka mbetur borxh bashkë me kryeministrin Haradinaj ta kthejë kufirin në Çakorr dhe Zhleb, sepse kanë qenë premtime të mëdha të tyre dhe ato premtime nuk mundet as Bulliqi, as kryeministri t'i mbulojë, njëri me dorëheqje, tjetri me kalim në parti tjetër", ka thënë Mustafa.

ë për shkëmbim të territoreve

jemi të bindur se nuk do të mbyllet më derisa të zgjidhet përfundimisht. Sepse zgjidhja e çështjes shqiptaro-serbe bëhet vetëm përmes ndërrimit të territoreve në bazë të vijave etnike. Vetëm kur të ndodhë kjo Kosovës i hapet perspektiva e zhvillimit dhe ajo e integritit kombëtar e ndërkombëtar", ka thënë ai, duke shtuar se partitë politike po e kundërshtojnë këtë ide për shkak të votave.

"Epoka e re": Z. Klinaku, tashmë është caktuar data për shpërndarjen e Kuvendit, pas së cilës do të caktohet edhe data e zgjedhjeve të parakohshme. Sa është e gatshme LB-ja për këto zgjedhje?

Klinaku: Këto zgjedhje ndoshta të gjithë i kanë zënë të papërgatitur, sepse kanë qenë të papritura ngase kanë ardhur nga një shkak i papritur. Sidoqoftë, çdo subjekt politik, sikurse edhe ne, duhet të mobilizohemi për këto zgjedhje. Nuk kemi rrugë tjetër.

"Epoka e re": A kanë diskutuar strukturat e LB-së se si do të shkohet në këto zgjedhje? Zakonisht ju keni shkuar në koalicionet parazgjedhore me subjekte të tjera politike?

Klinaku: Është e vërtetë se herëve të kaluara kemi bërë koalicionet parazgjedhore por, siç e di i gjithë opinioni, ato kanë qenë koalicionet jo mbi bazën programore, çka nuk do të ndodhë kësaj radhe. Lëvizja për Bashkim është e prerë në këtë drejtim: do të shkojë në koalicion parazgjedhor vetëm me ato subjekte politike të cilat vërtet janë të interesuara për ta zgjidhur problemin shekullor në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes ndërrimit të territoreve.

"Epoka e re": Mirëpo kjo ide e ndryshimit të kufijve e inicuar vitin e kaluar nga presidenti Thaçi është kundërshtuar fuqishëm nga të gjithë.

Klinaku: Kjo çështje nga presidenti është diskutuar vonë. Tanimë kjo çështje është aktuale këtu, por edhe në botën e jashtme. Partitë janë shprehur

kundër kësaj ideje, së paku kështu janë deklaruar në opinion, ani pse në debatet e brendshme të tyre është thënë diçka tjetër. Ne jemi të interesuar që kjo çështje të diskutohet botërisht dhe të analizohet me seriozitetin që meriton.

"Epoka e re": Meqenëse ideja e shkëmbimit të territoreve është kundërshtuar nga të gjitha partitë, me kë do të bëni koalicion?

Klinaku: Nëse të gjitha partitë politike vazhdojnë me këto deklarime kundër ndryshimeve të territoreve, atëherë ne nuk do të bëjmë koalicion me askënd, por do të shkojmë si të vetëm në zgjedhje.

"Epoka e re": Në zgjedhjet e kaluara keni qenë në koalicion me PDK-në. Ka pasur përpjekje të PDK-së për ta vazhduar bashkëpunimin edhe në këto zgjedhje?

Klinaku: Diskutime nuk ka pasur. Interesim nga ana e PDK-së ka pasur por, t'ju them të drejtën qysh në fillim, u kemi thënë se ata duhet të pozicionohen qartë në raport me zgjidhjen e çështjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

"Epoka e re": Pra, ju jeni të vendosur se koalicionet parazgjedhor do të bëni vetëm me atë parti që është pro shkëmbimit të territoreve Kosovë - Serbi?

Klinaku: Po, pavarësisht se cila është ajo parti. E rëndësishme është t'i ndihmojmë zgjidhjes së kësaj çështje. Pra, kësaj radhe ne i japim prioritet kësaj.

"Epoka e re": Si do ta vlerësoni debatin që është zhvilluar rreth kësaj çështje? A është bërë në mënyrën e duhur?

Klinaku: Faktikisht debat serioz për këtë çështje nuk ka pasur. Të gjithë këtë debat ia kanë përshtatur votës, pra kanë folur për qëllime elektorale. Ndërsa informatat që ne i kemi nga brenda partive politike, aty debatet ziejnë me kundërshtime rreth kësaj çështje. Por edhe sondazhet që janë bërë publike deri më tani kemi parë se deri në 30 për qind ka shkuar përkrahja e qytetarëve të

Kosovës për zgjidhjen e këtij problemi me anë të ndërrimit të territoreve. E shohim këtë si të vetmen mundësi për t'i dhënë fund konfliktit shekullor Kosovë - Serbi dhe Kosovës për t'iu hapur perspektiva të reja.

"Epoka e re": Pse mendoni se partitë e tjera politike po hezitojnë ta përkrahin publikisht këtë ide?

Klinaku: Po frikësohen nga opinioni, sepse kjo çështje për një kohë të gjatë ka qenë temë tabu. Ka qenë e tillë për shkak të pozicionit kundër të ShBA-së. Por meqenëse tani ka një vit që ShBA-ja në këtë drejtim ka ndërruar qasje dhe e ka hapur mundësinë për t'u diskutuar edhe për ndërrim të territoreve si një zgjidhje e përhershme. Mirëpo partitë politike konsiderojnë se opinioni ende është kundër kësaj ideje dhe për shkak të votave frikësohen të deklarohen publikisht për këtë çështje.

"Epoka e re": Por kryeministri në dorëheqje dhe shumë kundërshtarë të kësaj ideje kanë deklaruar se çështja e ndërrimit të territoreve është mbyllur?

Klinaku: Ata mund të mendojnë çka të duan, mirëpo kjo çështje tanimë është hapur dhe nuk është mbyllur. Kjo çështje ka qenë e mbyllur për më shumë se një dekadë. Këtë e di shumë mirë AAK-ja dhe z. Haradinaj, që kur përfaqësuesi i tyre ka qenë në proces të bisedimeve, kjo çështje ka qenë e mbyllur. Tanimë ajo është hapur dhe nuk mund të mbyllet më.

"Epoka e re": Ju jeni të bindur se ndërrimi i territoreve nuk do të mbyllet pa u zgjidhur?

Klinaku: Kjo çështje tashmë është hapur dhe jemi të bindur se nuk do të mbyllet më derisa të zgjidhet përfundimisht. Zgjidhja e çështjes shqiptaro-serbe bëhet vetëm përmes ndërrimit të territoreve në bazë të vijave etnike. Vetëm kur të ndodhë kjo Kosovës i hapet perspektiva e zhvillimit dhe ajo e integritit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Bashkim është e prerë në këtë drejtim: do të shkojë në koalicion parazgjedhor vetëm me ato subjekte politike të cilat janë të interesuar për ta zgjidhur problemin shekullor në mes të Kosovës dhe Serbisë përmes ndërrimit të territoreve", ka thënë ai.

Klinaku ka sqaruar se nëse askush prej subjekteve politike nuk e pranon kushtin e tyre, atëherë LB-ja do të garojë e vetme në këto zgjedhje. "Nëse të

gjitha partitë politike vazhdojnë me këto deklarime kundër ndryshimeve të territoreve, atëherë ne nuk do të bëjmë koalicion me askënd, por do të shkojmë të vetëm në zgjedhje", është shprehur ai.

Klinaku i ka quajtur të kotë zërat të cilët pretendojnë se çështja e shkëmbimit të territoreve është mbyllur. Sipas tij, kjo çështje nuk do të mbyllet derisa të zgjidhet përfundimisht. "Kjo çështje tashmë është hapur dhe

Hoxhaj: Sulmi në konsullatën e Kosovës, goditje ndaj sovranitetit

PRISHTINË, 16 GUSHT - Zëvendëskryeministri i Kosovës në detyrë, Enver Hoxhaj, ka akuzuar strukturat serbe të sigurisë për sulmin ndaj konsullatës së Kosovës në Danimarkë. "Sulmi në konsullatën tonë në Danimarkë në fillim u duk se ishte sulm i tifozëve huliganë të sportit, por doli të ishte një

veprim i planifikuar nga struktura shtetërore të sigurisë serbe. Ky është një dimension i ri për goditjen e sovranitetit të Kosovës", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Twitter".

Më 14 gusht ministri i Jashtëm në detyrë i Kosovës, Behgjet Pacolli, njoftoi se është sulmuar konsullata e

Kosovës në Kopenhagë. "Ne jemi duke punuar me autoritetet daneze për t'i sjellë përgjegjësit para drejtësisë", pati deklaruar Pacolli. Në anën tjetër, ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Daçiq, ka deklaruar të enjten se nuk ka asnjë informacion nëse ndonjë shtetas i Serbisë është arrestuar apo i dyshuar për

këtë rast. "I kam kontaktuar njerëzit tanë dhe më kanë thënë se autoritetet daneze nuk kanë bërë asnjë njoftim për këtë çështje dhe as nëse ndonjë nga qytetarët tanë janë të arrestuar ose duke u hetuar", ka thënë Daçiqi. Ai tha se me informacionet që ka të gjithë tifozët serbë janë kthyer në Serbi.



Ministri Tahiri: Nuk do të lejoj që Kosova të jetë strehë e kriminelëve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka njoftuar të premten për realizimin e suksesshëm të ekstradimit të një personi të dyshuar për vrasje të rëndë në Gjermani. Përmes kësaj deklarate për media, ministri Tahiri ka vlerësuar se Kosova nuk është dhe nuk do të jetë vend i sigurt dhe strehë për kriminelët. "Dje kam ekstraduar një person të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet gjermane, si i dyshuar për kryer-

jen e veprës penale vrasje e rëndë. Ka qenë jetike për sistemin tonë të drejtësisë që t'i japim fund praktikës së paradokohshme, kur Kosova konsiderohej strehë e sigurt për kriminelët dhe të dyshuarit që kryenin vepra të ndryshme penale. Këta të dyshuar shfrytëzonin zbrazëtitrat ligjore që t'i shmangen ballafaqimit me drejtësinë", ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se me ta marrë mandatin si ministër i Drejtësisë është kujdesur që t'i eliminojë menjëherë zbrazëtitrat ligjore për të vendosur para përgjegjësisë secilin person të dyshuar. "Kemi

arritur kështu ta bëjmë Kosovën vend të pasigurt për kriminelet dhe vend model për regjionin në luftimin e kriminit transnacional. Nuk do të lejoj që Kosova të jetë strehë e kriminelëve. Pavarësisht vendit që dyshohet ose kanë kryer veprën penale dhe shtetësisë që kanë, të gjithë të dyshuarit për vepra penale do të ndiqen dhe do të sillen para drejtësisë. Falë punës që kemi bërë si Ministri në rrafshin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, vetëm këtë vit kemi arritur të realizojmë 18 ekstradime nga Kosova për në shtetet e tjera", ka thënë ministri Tahiri.



Lista të pastra zgjedhore, ende vetëm dëshirë

PRISHTINË, 16 GUSHT - Në listat zgjedhore të partive politike në zgjedhjet parlamentare që mund të mbahen pas disa javësh mund të jenë të përfshirë sërish persona të dyshuar për korrupsion dhe krime, si dhe ata nën hetime dhe me akuzë nëpër gjykata. Një iniciativë e prezantuar vite më parë nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, përmes të cilit pretendohet t'u ndalohej pjesëmarrja në zgjedhje dhe puna në institucione shtetërore personave që kanë lëndë të hapura në gjykata, ende nuk është jetësuar.

Analisti i çështjeve politike nga Instituti Demokratik i Kosovës, Artan Murati, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nisma e presidentit Thaçi për lista të pastra zgjedhore nuk arriti të jetësohet pasi, siç thotë Murati, vetë presidenti nuk ka dhënë një shembull të mirë duke larguar njerëz të tillë nga pozitat institucionale që kanë mbajtur. "Presidenti Thaçi edhe në kohën kur ka qenë kryeministër nuk ka sjell një shembull të mirë që t'i largojë njerëzit që kanë qenë të apostrofuara për afëra korruptive apo çështje të tjera. Politikanët duhet të japin shem-



bull personal para se të ofrojnë opsione për publikun apo t'i pasojnë si ide", ka thënë Murati. Kuvendi i Kosovës pritet të shpërndahet më 22 gusht. Shpërndarja e Kuvendit të Kosovës u hap rrugë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Murati thotë se në këto zgjedhje partitë politike do të duhet të jenë të kujdesshme dhe se në listat zgjedhore nuk duhet të kenë të përfshirë persona nën hetime apo me të kaluar krimi-

nale. "Mënyra se si zhvillohet pastaj puna në institucione, qoftë në Kuvend, qoftë në qeveri, ndikon shumë se çfarë përmban një listë zgjedhore sepse këta individë, të cilësdo parti politike që do t'i fitojë zgjedhjet, do t'i japin formë mënyrës së qeverisjes, prandaj është e rëndësishme të garantohet integritet fillimisht brenda listave zgjedhore në mënyrë që t'i hapet rrugë integritetit të institucioneve të cilat do të

konstituohen pas zgjedhjeve të përgjithshme", ka theksuar Murati.

Përfaqësuesit e mekanizmave ndërkombëtarë para zgjedhjeve të fundit parlamentare në Kosovë patën kërkuar që partitë politike të mos i fusin në lista zgjedhore personat që janë përballur me procedura penale apo që kanë pasur të ngritura procedura penale.

Pavarësisht prej thirrjeve që u janë bërë nga diplomatë

ndërkombëtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, partitë politike në zgjedhjet e kaluara patën garuar edhe me kandidatë nën hetime, duke pretenduar se askush nuk është i fajshëm, përderisa nuk ka një vendim të prerë nga gjykata. Shpend Emini, drejtor ekzekutiv i organizatës Demokracia për Zhvillim, tha për "Radion Evropa e Lirë" se subjektet politike nuk i kanë respektuar thirrjet as të shoqërisë civile dhe as të përfaqësuesve ndërkombëtarë për lista të pastra zgjedhore.

Në mungesë të një kodi përmes të cilit do të pranoheshin rregullat e reja për pjesëmarrje në zgjedhje, lë të hapur mundësinë që partitë politike të vendosin vetë nëse në lista do t'i përfshijnë edhe personat me lëndë të hapura nëpër gjykata për vepra të ndryshme penale.

Gjatë të gjitha mandateve paraprake deputetë të Kuvendit të Kosovës, ministra të qeverisë dhe poste nën-ministore e deri te përfaqësuesit e institucioneve në nivelin lokal janë ballafaquar në vazhdimësi me aktakuza, gjykime dhe ndjekje penale.

Kamerat e sigurisë në qytetin e Malishevës do të mbikëqyren nga policia

Malishevë, 16 gusht (ER) - Nga e premtja edhe zyrtarisht sistemi i kamerave të sigurisë të vendosura në qytetin e Malishevës do të jetë i mbikëqyruar nga Policia e Kosovës. Për këtë qëllim, në Malishevë ka qëndruar edhe drejtori i Drejtërisë Rajonale të Policisë së Gjakovës, kolonel Lumni Graishta, i shoqëruar edhe nga komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, të cilët

janë takuar me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për kalimin e sistemit të kamerave të sigurisë në mbikëqyrje të Policisë së Kosovës. Kjo është bërë me qëllim të rritjes së sigurisë publike për qytetarët dhe pronën në qytetin e Malishevës. Komuna e Malishevës ka investuar në vendosjen e sistemit të kamerave të sigurisë me qëllim të rrit-

jes së ofrimit të sigurisë publike.

Kryetari i komunës, Ragip Begaj dhe eprorët e lartë policorë, kolonel Graishta dhe kapiten Krasniqi, kanë biseduar edhe për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve, për rritjen e sigurisë publike në territorin e Komunës së Malishevës dhe për mundësinë e zgjerimit të sistemit të kamerave në të gjitha pikat kyçe në Komunën e Malishevës.



Ministri Ismaili i siguron mjekët dhe infermierët: Pagat do t'i merrni me rritje

"Sot jemi këtu që t'ju sigurojmë se pagat do t'i merrni me rritje në fund të këtij viti. Jemi këtu që t'jua heqim çdo dyshim që mund të keni rreth implementimit të ligjit për paga i cili u garanton profesionistëve shëndetësorë pagat më të larta në rajon", u ka thënë të premtën ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, profesionistëve shëndetësorë në QKUK



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, i shoqëruar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, kanë zhvilluar të premtën një takim me profesionistët shëndetësorë. Gjatë këtij takimi ministrat Ismaili dhe Hamza, krahas temave të tjera, kanë folur edhe për rritjen e pagave për mjekët dhe infermierët. Ministri Ismaili ua ka hequr çdo dyshim mjekëve dhe infermierëve se nga fundi i këtij viti ata do t'i marrin pagat me rritje në bazë të ligjit të ri për pagat. "Sot jemi këtu që t'ju sigurojmë se pagat do t'i merrni me rritje në fund të këtij viti. Jemi këtu që t'jua heqim çdo dyshim që mund të

keni rreth implementimit të ligjit për paga i cili u garanton profesionistëve shëndetësorë pagat më të larta në rajon", u ka thënë të premtën ministri Ismaili profesionistëve shëndetësorë në QKUK. Ministri Ismaili foli edhe për investimet që do ta vazhdojnë përmirësimin e kushteve për profesionistët shëndetësorë. Në anën tjetër, ministri Bedri Hamza, ka thënë se ministri Ismaili ka qenë një prej ministrave më të "vështirë" për ta finalizuar buxhetin. "E kemi finalizuar buxhetin. Unë kam zhvilluar së paku pesë takime me ministrin Ismaili. Ai gjithmonë ka kërkuar paga më të mëdha për ju", ka thënë ministri Hamza.

Më tutje, edhe ministri Hamza ka thënë se ligji i ri për pagat

do të implementohet që nga fundi i këtij viti. "Unë i siguroj të gjithë ata që do të marrin pagat në kuadër të ligjit të ri, që ato do t'i marrin me rritje nga ky vit", ka thënë ministri Hamza.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, në emër të profesio-

istëve shëndetësorë ka falënderuar ministrin Ismaili dhe ministrin Hamza për përkushtimin e tyre për përmirësimin e kushteve të mjekëve dhe infermierëve. "Ka qenë një përkushtim i jashtëzakonshëm i ministrit Ismaili, edhe i ministrit Hamza, falë të cilëve

sot profesionistët shëndetësorë në të gjithë Kosovën do t'i gëzojnë pagat më të larta në rajon", ka thënë drejtori Sejdiu.

Me ligjin e ri për paga, mjeku specialist në Kosovë, në vend të 661 eurove, do të marrë pagë prej 1 195 euro.

O'Connell: FSK-ja është një prej sukseseve të Kosovës pas luftës

PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ka pritur në takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell.

Në takim ministri e ka falënderuar ambasadorin për kontributin e tij të veçantë për thellimin e raporteve dypalëshe midis Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Në takim u bisedua edhe për përparimin e arritur në zbatimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe për përkrahjen e rezervë që ka dhënë dhe po jep Mbretëria e Bashkuar për shkollimin dhe stërvitjen e pjesëtarëve të FSK-së. Me theks të veçantë u diskutua suksesi i kadetëve tanë gjatë shkollimit në Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera. Ata i kanë përfaqësuar më së miri vlerat që kultivon FSK-ja si një forcë profesionale, shumetnike dhe kredibile.

Ambasadori Ruairi O'Connell e ka falënderuar ministrin Berisha për bashkëpunimin e deritashëm dhe ka vlerësuar se FSK-ja është një prej sukseseve të Kosovës pas luftës. Ai ka shtuar se FSK-ja është ndërtuar si institucion



duke u bazuar në meritë dhe profesionalizëm. Ambasadori e rikonfirmoi edhe përkushtimin e Mbretërisë së Bashkuar për ta

vazhduar përkrahjen ndaj Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Ministri Berisha edhe një herë ka

shprehur gatishmërinë që FSK-ja, edhe me kapacitetet e tanishme, të kontribuojë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, gjithashtu

edhe si pjesë e kontingjenteve të partneriteteve strategjike, siç është Mbretëria e Bashkuar në misionet paqeruajtëse në botë.

ATK-ja, aktivitete shitesë gjatë sezonit të verës


PRISHTINË, 16 GUSHT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është duke vazhduar zbatimin e planit operativ sezonal i cili zhvillohet brenda dhe jashtë orarit të punës, me qëllim të monitorimit sa më të mirë të veprimtarive rekreative, argëtuese, përfshirë organizimet nëpër hotele dhe

restorante, koncertet, dasmat, si dhe veprimtari të ngjashme të cilat në këtë sezon janë më të theksuara. "Këto aktivitete ndërmerren me qëllim që të sigurohen dëshmi të ndryshme, në lidhje me të hyrat që realizohen nga ky sektor. Bazuar në dëshmitë që krijohen gjatë këtyre

aktiviteteve, si dhe bazuar në faktet e tjera të siguruara, ATK bën vlerësimin e obligimeve të këtij sektori. Deri më tani nga aktivitetet e zhvilluara në terren janë inspektuar lokacione të ndryshme, te veprimtaritë e lartcekura, në qytete të ndryshme të Kosovës, ku edhe janë konstatuar parregullsi ose

mosrespektim i kërkesave të cilat dalin nga Legjislacioni tatimor", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Sipas këtij njoftimi, raporti final lidhur me implementimin e planit sezonal do të publikohet gjatë muajit shtator 2019. "Menaxhimet i ATK-së me përkushtim do të vazhdoj t'i



zbatoj të gjitha dispozitat ligjore, në mënyrë që secili tatimpagues ta deklaroj drejt pjesën që i takon me ligj", është theksuar në njoftimin e ATK-së.

Ministri Shala vendos masa reciproke për produktet e Maqedonisë së Veriut

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 GUSHT - Që nga qershori i këtij viti kur produktit të Kosovës, rasatit të peshkut, i janë vendosur barrierat tarifore nga ana e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se për këtë çështje ka qenë në kontakt me autoritetet e këtij shteti dhe ka dërguar ankesa nëpërmes sekretariatit të CEFTA-s, por edhe letër personale ministrit të tyre të Ekonomisë, por deri më tani

nuk ka marrë kurrfarë përgjigje. "Dhe tashmë kanë kaluar dy muaj dhe nuk kemi asnjë përgjigje, prandaj jam i detyruar që në mbrojtje të interesit të Kosovës, biznesit kosovar dhe në mbrojtje të prodhimeve tona, të ndërmarr veprime të tjera ligjore në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës. Sot kam marr vendim që të vendos masa reciproke për produktet e Maqedonisë së Veriut që importohen në Kosovë dhe ta ndaloj hyrjen e disa produkteve në mënyrë që ta detyroj shtetin e Maqedonisë së Veriut që të reflektoj dhe të ketë tret-

man të barabartë për produktet e Kosovës që hyjnë në atë shtet", ka thënë Shala.

Ai ka theksuar se reciprociteti, partneriteti dhe trajtimi i barabartë i prodhimeve kosovare gjatë eksportit në vendet e rajonit është e vetmja rrugë me të cilën duhet të ecim përpara. "Në rast se ky tretman do të vazhdojë ne do të marrim edhe hapa të tjerë jo vetëm ndaj këtij shteti, por edhe shteteve të tjera. Tashmë asnjë pranim i Kosovës që eksportohet jashtë nuk do të ketë tretman të pabarabartë", është shprehur ministri Shala.



Komuna e Deçanit pastron disa deponi me mbeturina

DEÇAN, 16 GUSHT (ER) - Komuna e Deçanit ka bërë me dije se ka pastruar disa deponi me mbeturina në territorin e kësaj komune. Me këtë rast, kjo komunë ka kërkuar nga qytetarët ta mbajnë ambientin të pastër. "Të

nderuar qytetarë, ju kujtojmë se deponitë në 'Podin e Gështenjave' në 'Rrugën e UÇK-së' në Deçan, në Llukë të Epërme dhe deponia në më të mes fshatit Lumbardhë dhe Broliq, janë pastruar. Në mënyrë që këto vende të mbesin të pastra, ju lusim që tani e tutje të keni më shumë kujdes. Ne si institucion në vazhdimësi po bëjmë përpjekje që ta mbajmë ambientin e pastër andaj edhe kontributi juaj do të jetë shumë i vlefshëm duke hedhur mbeturinat në vendin e duhur. Ju faleminderit për mirëkuptim!", ka njoftuar Komuna e Deçanit.



140 mijë euro subvencione vetëm këtë vit për bujqësinë në Skenderaj

SKENDERAJ, 16 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se për këtë vit janë ndarë 140 mijë euro subvencione për bujqësinë. "Duke bërë shpërndarjen e mjeteve bujqësore në kuadër të mbështetjes së drejtpërdrejtë për fermerët e vyeshtëm që e duan punën, e prej së cilës krijojnë të ardhura, ne jo vetëm se e përmbushim obligimin për ta zhvilluar bujqësinë, por edhe po ndjekim shembujt e suksesshëm, duke rritur vendet e punës dhe prodhimin. Ndarja e sotme e 30 motokultivatorëve dhe 40



makinave mjelëse është tjetër dëshmi e përkushtimit tonë që bujqësinë, si një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillim ekonomik, ta fuqizojmë sa më shumë që mundemi", ka thënë kryetari Jashari.

Komuna e Prizrenit të hënën fillon dëgjimet publike për buxhetin e vitit 2020

PRIZREN, 16 GUSHT (ER) - Komuna e Prizrenit në kuadër të hartimit të buxhetit për vitin 2020 duke filluar nga 19 gushti do të organizojë dëgjime publike me qytetarët e kësaj komune, me qëllim të angazhimit të tyre në procesin e hartimit të buxhetit, transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies ndaj tyre. Për hartimin e buxhetit për vitin 2020 do të organizohen pesë dëgjime publike me qytetarë, përfshirë katër në fshatrat krye-

sore të rajoneve të ndryshme dhe një në qytet, përkatësisht në sallën e kuvendit në shtëpinë e bardhë, që do të jetë i hapur për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Komuna e Prizrenit për vitin 2020 do të ketë buxhet prej 50 901 457 eurosh, prej të cilit 43 341 162 euro janë nga granti qeveritar dhe 7 560 295 euro të tjera nga të hyrat vetjake. Në krahasim me vitin 2019, për vitin 2020 Komuna e Prizrenit do të ketë 7.32 për qind

ritje të buxhetit të përgjithshëm, duke përfshirë rritje prej 13.1 përqindësh në kategorinë e pagave, 8.48 përqind në kategorinë mallra dhe shërbime, si dhe 50 për qind në kategorinë e subvencioneve.

Kjo komunë ka ftuar të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e lagjeve, bashkësive lokale dhe përfaqësuesit e OJQ-ve që të jenë të pranishëm në këto dëgjime dhe ta japin kontributin e tyre në hartimin e buxhetit për vitin 2020.

DËGJIM PUBLIK

Për buxhetin e vitit 2020

19 gusht, 19:00 - GJONAJ, Shtëpia e kulturës
20 gusht, 19:00 - ZHUR, Shkolla fillore
21 gusht, 19:00 - REÇANË, Shtëpia e kulturës
22 gusht, 19:00 - KORISHË, Shkolla fillore
23 gusht, 10:00 - PRIZREN, Shtëpia e Bardhë

Fillon Festivali 'Hardh Fest 2019'

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

RAHOVEC, 16 GUSHT - Në Rahovec është hapur të premten Festivali i Rrushit "Hardh Fest 2019" i cili sivjet organizohet me moton "Një got' për mot", e në të cilin ishin të pranishëm presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, deputetë dhe ministra. Nikoqirja e festivalit, Fahrije Hoti, themeluese dhe drejtore e Kooperativës Bujqësore "Krusha e Madhe", pasi ka përshëndetur mysafirët, ka thënë se ndien kënaqësi dhe privilegj të jetë në rolin e nikoqirit të festivalit, i cili më së miri promovon vlerat e Rahovecit në mbarë botën.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se toka e Rahovecit është më

punëtore në Kosovë. "Sot qyteti ynë hap dyert, zemrat, bujarinë dhe fisnikërinë për mysafirë", ka thënë ai, duke falënderuar në vazhdim Këshillin Organizativ për punën e tyre të palodhshme.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në fjalën e tij ka thënë se sot është ditë e veçantë jo vetëm për Rahovecin, por edhe për Kosovën pasi, sipas tij, prodhimi kryesor rahovecas, vera, tashmë është e pranishme në tryezat e të gjitha kontinenteve. "Kultivimi i hardhisë në këtë pjesë të Kosovës është edhe dëshmi e orientimit tonë evropian, i cili është i rrënjësor thellë në vlerat e lashta perëndimore. 'Hardh Fest' ka arritur të ndërkombezarizohet, të sjellë emra të njohur të artit ndërkombezar në Rahovec, të organizojë aktivitete shumë atraktive që kanë tërhequr vëmendje edhe botërore. Urime të gjithë vreshtarëve festa e vjel-



jes së rrushit", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërkaq presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, derisa ka

numëruar tri arsyet pse është i pranishëm sot në Rahovec, ka theksuar se ka vërejtur kapacitete të jashtëzakonshme

prodhuese në Rahovec. Ai ka thënë se kjo festë nuk është vetëm gëzim, por edhe mbështetje e madhe prodhuesve të verës. "Populli i Rahovecit meriton mirënjohje të veçantë, sepse sot vera e Rahovecit është kudo në botë", ka thënë presidenti Meta.

Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se institucionet duhet të fokusohen në politika fiskale dhe lehtësira tatimore në përkrahje të fermerëve. "Do të vazhdojmë me lehtësira tatimore dhe me politika fiskale në mbështetje të prodhimit vendor. Gjithmonë në krah të rahovecianëve për një jetë më të mirë e më të dinjitetshme", ka thënë Haradinaj.



Qytetarët e Kosovës tymosin mbi 300 milionë euro duhan

Prishtinë, 16 gusht - Rreth tre mijë tonë duhan, në vlerë mbi 300 milionë euro, është sasia e duhanit që shpenzojnë qytetarët e Kosovës brenda një viti. Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se nga kjo shumë e përgjithshme 200 milionë euro është shuma që përfiton buxheti i shtetit në akcizë, TVSh dhe taksë doganore. Kosova ka mbi 20 për qind të popullsisë duhanpirëse. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë se trendi i importit të duhanit në Kosovë është pothuajse i njëjtë nga viti në vit, por që rritja e akcizës ka rritur edhe koston. "Importi i duhanit në Kosovë ka një trend të njëjtë nga viti në vit. Rreth tre mijë tonë brenda vitit importohen në Kosovë. Akciza e duhanit paguhet 43 euro për një kilogram, derisa 18 për qind paguhet TVSh, si dhe taksa e doganës. Nëse mblid-



hen të gjitha këto, i bie se rreth 200 milionë euro paguhen këto shërbime, kurse 100 milionë vetëm duhani", ka thënë Stavileci.

Akciza e duhanit është rritur disa herë. Prej 27 eurosh për një kilogram cigare sa ka qenë në vitin 2012, në 41 euro në vitin 2016 dhe në vitin 2018 është ngritur në 43 euro. Në vitin 2013 në Kosovë ka hyr në

fuqi Ligji për kontrollin e duhanit, por që zbatimi i tij ende vlerësohet se nuk është në nivelin e kënaqshëm.

Shkumbin Spahiu, zyrtar në Qendrën për Zhvillim dhe Avokim në Kosovë (KADC), njëherësh monitorues i zbatimit të Ligjit për kontrollin e duhanit, ka thënë se gjatë dy vjetëve të para të hyrjes në fuqi të Ligjit për duhanin ai

ishite zbatuar në masë të madhe, por me kohë, sipas tij, zbatimi i tij ka filluar të zbehet. "Shuma prej 300 milionë eurosh, apo 400 mijë pako cigare në ditë ose mbi 20 për qind e popullatës që konsumojnë duhan është tejet e lartë. Kjo tregon për nivel të ulët të vetëdijes së popullatës dhe mungesën e zbatimit të ligjit. Vitin e fundit kemi pasur një rënie të madhe të monitorimit të zbatimit të Ligjit kundër duhanit çka edhe ka ndikuar të ketë ulje të zbatimit të ligjit, për dallim nga dy vjetët e para të fillimit të implementimit të ligjit e që ishte shumë i suksesshëm", ka deklaruar Spahiu.

Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, ka thënë se sipas raportit të fundit që ky institucion e ka, përqindja e përdoruesve aktualë të duhanit në mesin e të rinjve 13-15 vjeç krahasuar me hulumtimin e kaluar nga

6.7 për qind në vitin 2014, është ulur në 4.4 për qind në vitin 2016, ndërkohë që ekspozimi ndaj tymit të duhanit brenda ndonjë ambienti të mbyllur është ulur nga 84 në 43 për qind.

Përqindja e përdoruesve aktualë të duhanit në mesin e të rinjve, krahasuar me hulumtimin e kaluar, është nga 10.4 në 8.8 për qind. Sipas raportit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), mbetet e duhanit përmbajnë mbi 7 000 lëndë kimike toksike që helmojnë mjedisin, përfshirë këtu lëndë që shkaktojnë kancerin.

OBSh-ja ka paralajmëruar se më shumë se shtatë milionë njerëz në gjithë botën, vdesin çdo vit nga sëmundjet që shkaktohen nga pirja e duhanit. Një pasojë e tillë, përveç dëmeve shëndetësore dhe rrezikimit të jetëve të njerëzve, vlerësohet se shkakton dëme të mëdha edhe për ekonominë e vendeve të ndryshme.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (19)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin
NOVOSELLA**

Bacë, çka të them!...
E paça në kujtesë shëmbëlltyrën
Tënde derisa të vijë te Ju!

30 korrik 2018,
Bedri Zyberaj, Rahovec

Baca Adem,
Ishe i lindur me ideale kombëtare
të cilat i dashurove me fjalë dhe
me vepra. Ishe i drejtë dhe i sin-
qertë, andaj lufta juaj për drejtësi,
triumfoi edhe mbi hipokrizinë!
Nuk ishe hakmarrës për shkak të
dhunës, andaj askujt nuk ia le për
tjetrën botë, por iu the troç të
vërtetën. Zoti i madhërishtëm të
shpërbleftë me xhenet.

30 korrik 2018,
Mulla Hajrullah Hoxha, Prishtinë

Nderime vizionarit më të madh
shqiptar, i cili nuk vdes kurrë!
Lavdi Bacës, Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Ahmet Bajqinovci

I sinqertë, i guximshëm! Borxh
askujt! Lus zotin ta shpërblejë me
xhenet!

30 korrik 2018,
Mulla Osman Musliu

Ishe Apostulli i shqiptarizmës,
Baca Adem Demaçi! Brezat do të
të kujtojnë me pietet, se ishe
Piemonti i Lavdisë sonë
Kombëtare! Lavdi jetës dhe
veprës Sate!

30 korrik 2018,
Islam Gega

Lavdi veprës tënde, shembullit
tënd të sakrificës për liri të mbarë
kombit shqiptar! Do të jetosh në
zemrat tona, i madhi baca Adem
Demaçi!

30 korrik 2018,
Fabri Drevinja

I papërsëritshmi, frymëzuesi e
ideologu, Baca, Adem Demaçi
moti qëndron i papërkulur për-
ballë çdo stuhie. Ai është vet liria
dhe pavarësia e Kosovës. Lavdi
për jetë e mot, hero i heronjve,
Baca, Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Dardan Beqir Beqiri, Asllan
Bajrami, Bajram Beqiri

Njeriu i madh i kombit shqiptar, i
pavdekshmi, baca Adem Demaçi!
Lavdi veprës se Tij!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Rruga e Adem Demaçit do të
mbetet udhërrëfyese për ne.
